

MARRËVESHJE FINANCIMI

KUSHTET SPECIFIKE

Komisioni Evropian, në vijim i referuar si “Komisioni” ose “pala”, i cili vepron në emër të Bashkimit Evropian, në vijim i referuar si “Unioni”,

nga njëra anë, dhe

Qeveria e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Integritimit Evropian dhe Qeveria e Kosovës* e përfaqësuar nga Ministria e Integritimit Evropian, të referuara bashkërisht në vijim si “përfituesit e IPA II” ose të referuar veçmas si “**përfitues i IPA II**”, ose “palët”,

nga ana tjetër,

dhe të referuar bashkërisht si “palët”

KANË RËNË DAKORT PËR SA MË POSHTË:

Neni 1 – Programi i Veprimit

(1) Unioni bie dakord për të financuar dhe përfituesit IPA II bien dakord për të pranuar financimin e alokimit të 2016 Programit të Veprimit në vijim siç përshkruhet në Shtojcën I:

Programi i veprimit të programit të bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri-Kosovë për vitet 2015 - 2017

Numri i angazhimit global (CRIS): 2016/ 038-154

Ky program veprimi financohet nga buxheti i Unionit duke u bazuar në: Instrumentin e Asistencës së Para-Aderimit (IPA II)¹.

(2) Kostoja totale e vlerësuar e alokimit të 2016 të këtij Programi Veprimi është 1 411 765 euro dhe maksimumi i kontributit të Unionit për këtë Program Veprimi është 1 200 000 euro.

Nga përfituesit IPA II nuk kërkohet kontribut financiar.

¹Rregullorja (BE) Nr 231/2014 datë 11 Mars, e cila krijon Instrumentin e Asistencës së Para Aderimit (IPA II) FZ L 77, 15.03.2014, f. 11.

* Ky emërtim nuk cenon qëndrimet në lidhje me statusin dhe është në pajtim me Rezolutën 1244/1999 dhe me Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Pavarësisë të Kosovës.

Neni 2 – Periudha e ekzekutimit dhe periudha operacionale e zbatimit

- (1) Periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Financiare, siç përcaktohet në Nenin 1(1) të Shtojcës II është caktuar të jetë 12 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financiare.
- (2) Periudha e zbatimit operacional të kësaj Marrëveshjeje Financiare, siç përcaktohet në Nenin 1 (2) të Shtojcës II është 6 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financiare.

Neni 3 – Adresat dhe Komunikimi

Të gjitha komunikimet që lidhen me zbatimin e Marrëveshjes Financiare duhet të jenë në formë të shkruar, duhet ti referohen shprehimisht Programit të Veprimit siç parashikohet në Nenin 1 (1) dhe duhet të dërgohen në adresat si më poshtë:

a) për Komisionin

Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat për Zgjerimin (DG NEAR)
Directorate D
Rue de la Loi 15
B-1049 Brussels
Belgium
Telefon: +32 (0)229-57198
Adresa e email-it: NEAR-D4@ec.europa.eu

b) për përfituesit e IPA II

Ministria e Integritimit Evropian
Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Sheshi Nënë Tereza 1010
Tirana, Albania
Telefon: +355 (0)4 228645
Adresa e e-mail-it: info@integrimi.gov.al

Ministria e Integritimit Evropian
Godina e Qeverisë, Kati 9, Zyra 905.910.
Rruga Nënë Tereza 10000 Prishtinë, Kosovo
Telefon: +381 (0) 38 200 27 001
Adresa e e-mail-it: mei@rks-gov.net

Neni 4 – Pika e kontaktit OLAF

Pikat e kontaktit e përfituesit IPA II që kanë kompetencat e duhura për të bashkëpunuar drejtpërdrejt me Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF), me qëllim lehtësimin e aktiviteteve të OLAF-it, do të jenë: Drejtori i Njësisë së Inspektimit Financiar së Ministrisë së

Financave të Shqipërisë dhe Z. Demush Shasha, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Integritimit Evropian në Kosovë, Koordinator Kombëtar i IPA (Demush.Shasha@rks-gov.net).

Neni 5 – Marrëveshjet Kuadër

Programi i Veprimit do të zbatohet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi marrëveshjet për zbatimin e asistencës financiare të Unionit për Shqipërinë nën Instrumentin e Asistencës së Para-Aderimit (IPA II), i cili ka hyrë në fuqi më 16 Prill 2015 dhe në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi masat për zbatimin e asistencës financiare të Unionit për Kosovën nën Instrumentin e Asistencës së Para-Aderimit (IPA II), i cili ka hyrë në fuqi më datë 16 Prill 2015, përkatësisht (më poshtë e referuar si “Marrëveshje(t) Kuadër”).

Kjo Marrëveshje Financimi plotëson dispozitat e Marrëveshjeve Kuadër të lartpërmendura. Në rast konflikti midis dispozitave të Marrëveshjes së Financimit nga njëra anë, dhe dispozitave të Marrëveshjes Kuadër përkatëse nga ana tjetër, do të kenë përparësi këto të fundit.

Neni 6 - Shtojcat

(1) Kjo Marrëveshje Financimi përbëhet nga:

- a) Këto Kushte Specifike;
- b) Shtojca I: Programi i Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Shqipëri-Kosovë për vitet 2015-2017 - Vendimi Zbatues i Komisionit C(2015)5238, datë 22 korrik 2015;
- c) Shtojca IA: Programi IPA II BNK 2014-2020 midis Shqipërisë dhe Kosovës;
- d) Shtojca II: Kushtet e Përgjithshme;
- e) Shtojca III: Modeli i Raportit Vjetor BNK mbi zbatimin e asistencës IPA II (Neni 80 i Marrëveshjes Kuadër);
- f) Shtojca IIIA: Modeli i raportit vjetor mbi zbatimin e asistencës IPA II në përputhje me Nenin 58 të Marrëveshjes Kuadër;

(2) Në rast të një konflikti midis dispozitave të shtojcave nga njëra anë dhe dispozitave të Kushteve Speciale nga ana tjetër, do të kenë përparësi këto të fundit. Në rast konflikti midis dispozitave të Shtojcës I dhe Shtojcës IA nga njëra anë dhe dispozitave të Shtojcës II nga ana tjetër, do të zbatohen këto të fundit. Në rast konflikti midis dispozitave të Shtojcës I dhe Shtojcës IA, do të zbatohen dispozitat e para.

Neni 7 – Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Financimi hyn në fuqi datën në të cilën Komisioni merr njoftim nga vendi i fundit përfitues i IPA II, i cili konfirmon përfundimin e procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi. Komisioni duhet të informojë përfituesit IPA II për datën e marrjes së këtij njoftimi. Nëse Komisioni nuk merr njoftim deri më 31 Dhjetor 2017, Marrëveshja e Financimit nuk hyn në fuqi.

Kjo Marrëveshje është hartuar në tre kopje origjinale në gjuhën angleze, nga të cilat një do i dorëzohet Komisionit dhe dy të tjerat përfituesve IPA II.

Për përfituesin IPA II:

Znj. Klajda Gjoshja
Ministre e Integrimit Evropian
Koordinatore Kombëtare e IPA-s
Bulevardi Dëshmorët e Kombit
Sheshi Nënë Tereza 1010
Tiranë, Shqipëri

Datë:

Z. Bekim Çollaku
Ministër i Integrimit Evropian
Ministria e Integrimit Evropian
Sheshi Skënderbeu, N.N.
10000 Prishtinë, Kosovë

Datë:

Për Komisionin:

Znj. Genoveva Ruiz Calavera
Drejtor
Komisioni Evropian
DG NEAR / D
Rue de la Loi 15
B-1049 Bruksel, Belgjikë

Datë: